



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Raport për tremujorin e dytë 2023

Oda e Mjekëve të Kosovës



Korrik 2023

Prishtinë

Përmbajtja:

Raport për tremujorin e dytë 2023	1
1. Këshilli Drejtues.....	3
2. Anëtarësimi	4
3. Mbikëqyrja etiko-profesionale	5
4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	5
5. Licencimet.....	6
6. Këshilli Mbikëqyrës	6
7. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së	7
8. Komisioni për Edukim Specialistik.....	7
9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke.....	7
10. Raporti financiar.....	8
11.2 <i>Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional</i>	8
11.3 <i>Prokurimi</i>	9
12 Aktivitete të tjera.....	10
12.1 Botimi i Revistës Mjeku	10
12.2 Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim	10
12.3 Ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së	12
12.4 Marrëdhëniet ndërkombëtare	12
12.5 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike	13
13 Plani i veprimit për 2023	14

1. Këshilli Drejtues

Në periudhën kohore prill – qershor 2023, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur tri (3) takime si dhe në një (1) rast kanë votuar elektronikisht përmes e-mailit ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën prill–qershor	Vendimet/ Përgjigjet sipas kërkesave/ ankesave të pranuar për periudhën prill–qershor	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën prill–qershor	Vendime/ Përgjigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	12	27	1	<ul style="list-style-type: none"> - Vendim për aprovimin e kërkesës së Komisionit AD HOC për vlerësimin e profilizimeve të veçanta për përkrahje financiare nga OMK - Vendim për organizimin e tryezës së rrumbullaket - 10 vjetori i OPSH-ve - Vendim për aprovim të propozimit nga Klinika e Pediatriisë për dhënien e mirënjohjeve të OMK-së, për mjekët e huaj nga Austria dhe Holanda që asistuan në Klinikën e Pediatriisë - Vendim për Raportin e punës për periudhën tre mujorit të parë (TM1) 2023 - Vendim për pasqyrat financiare dhe raportin e Auditoreve të pavarur për periudhën janar-dhjetor 2022 - Vendim për ri-alokim të mjeteve të ndara për linjen buxhetore për përkrahje të shoqatave për financimin e programeve të akredituara - Vendim për propozimet e Komisionit Ad-Hoc për vlerësimin dhe përkrahjen financiare të Profilizimeve të Veçanta 	5

2. Anëtarësimi

Gjatë periudhës kohore prill – qershor 2023, në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 67 mjekë, nga të cilët janë 5 mjekë të punësuar në sektorin publik, 11 mjekë të punësuar në sektorin privat, 49 mjekë të papunë dhe 2 mjekë në pension.




Tabela 1.1: Anëtarësimet për periudhën kohore prill - qershor 2023




Tabela 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 30 qershor 2023

Gjatë kësaj periudhe janë ndarë nga jeta 2 mjekë si dhe janë rianëtarësuar 16 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 30 qershor 2023 është 5123 mjekë.


3. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM 2	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën TM 2	Sanksionet e shqiptuara për periudhën TM 2	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën TM 2	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	9	8	N/A	N/A	3	12
Këshilli Etik	9	9	Rekomandime kolegjale 6 Qortim Publik 2	Rekomandime kolegjale 6 Qortim publik 2	4	13
Gjyqi i Nderit	0	0	///	///	0	0
Certifikatat e të kaluarës etike	107	///	///	///	///	///


4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë periudhës prill - qershor 2023 ka akredituar 37 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, 13 shoqata kanë bërë kërkesë për përkrahje financiare për organizimin e aktiviteteve prej të cilave 10 janë aprovuar ndërsa 3 prej tyre janë refuzuar nga Komisioni. Ndërsa 9 prej këtyre akreditimeve janë me taksë administrative.



5. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional gjatë periudhës prill - qershor 2023, ka lëshuar 215 licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:



6. Këshilli Mbikëqyrës

Gjatë periudhës prill-qershor 2023 Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur tri (3) takime ku kanë shqyrtuar: Raportin e punës së OMK-së për tremujorin e parë 2023, Pasqyrat financiare dhe raportin e Auditorëve të pavarur për vitin 2022, Vendimet e Këshillit Drejtues, Këshillit Etik, Prokurorit, Gjyqit të Nderit të OMK-së dhe të organeve të tjera të OMK-së.

7. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Në periudhën kohore Prill- Qershor 2023, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar gjithsej 25 kërkesa për leje – hulumtime dhe janë marrë 25 vendime, ku prej tyre kanë qenë 24 vendim për leje-hulumtim dhe 1 vendim për kthim raporti.

8. Komisioni për Edukim Specialistik

Në periudhën kohore prill - qershor 2023, Komisioni për Edukim Specialistik ka mbajtur një (1) takim. Përgjatë këtij takimi komisioni ka diskutuar për Udhëzimin Administrativ për Shkollim Specialistik 01/2023.

9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

Në periudhën kohore prill-qershor 2023, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së nuk ka pranuar asnjë kërkesë për dhënien e ndihmës solidare anëtarëve të OMK-së apo të familjarëve të tyre.

10. Raporti financiar

RAPORTI FINANCIAR DERI ME 30 QERSHOR 2023

1.0 Të hyrat:			
1.1 Paraja në bankë me 31.12.2022	€ 810,867.00		
Total Paraja në bankë me 31.12.2022			€810,867
1.2 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	TOTAL
1.2.1 Të hyrat nga anëtarësia:			
1.2.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 271,885	€ 92,721	€ 364,606
1.2.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€ 3,380	€ 3,520	€ 6,900
1.2.2 Licencimi	€ 20,250	€ 14,130	€ 34,380
1.2.3 Të hyrat e tjera*	€ 11,229	€ 11,777	€ 23,006
Të hyrat deri me 30.06.2023	€ 306,744	€ 122,147	€ 428,892
Paraja në bankë me 31.12.2022			€ 810,867
TOTAL TË HYRAT			€ 1,239,759

2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	TOTAL
2.1 Paga, meditje dhe kontributet pensionale	€ 66,904	€ 57,578	€ 124,482
2.2 Material shpenzues	€ 2,220	€ 2,905	€ 5,125
2.3 Reprezentacioni	€ 1,033	€ 561	€ 1,594
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 16,671	€ 94,698	€ 111,370
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 12,855	€ 12,624	€ 25,479
2.6 Shpenzimet e aseteve	€ 2,895	€ 1,550	€ 4,445
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 2,000	€ -	€ 2,000
Llogaritë e pagueshme me 31.12.2022	€ 9,510		€ 9,510
Llogaritë e pagueshme me 30.06.2023	€ (10,542)	€ (6,313)	€ (6,313)
TOTAL SHPENZIMET 30.06.2023	€ 103,546	€ 163,604	€ 277,692
Neto të hyrat për TM 2 - 2023	€ 203,198	€ (41,456)	€ 151,200
TOTAL BILANCI 30.06.2023			€ 962,067

1.2.3*Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, Riregjistrim në regjistrin OMK, Faksimili, Faksimili i dytë, Certifikata për të kaluarën etike profesionale, Taksa për paraqitjen e provimit, Kongreset, simpoziumet, seminarët, Lejimi për hulumtime për persona juridik, Të ardhurat nga interesi BKT, Dhurata / donacione, Të ardhura nga taksa në panair të Kongresit të OMK-së, Të ardhurat të tjera.

2.5 *Faksimili, Shpenzimet për botimin e revistës, Organizimi i mbledhjeve të kuvendit, Shpenzimet e ID kartelave të Odë, Shpenzime të përkthimeve/lektorimit, Meditje për udhëtime zyrtare, Trajnime për stafin, Mirembajtja e softverit për financa, Mirëmbajtja e mobilieve, pajisje, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Shpenzime të auditimit, Anëtarësimi në CPME, Shpenzimet e tjera operative.

11.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës në bazë të konkursit publik për përkrahjen financiare të aktiviteteve të veçanta të EVP-së, gjatë periudhës prill - qershor 2023 ka akorduar përkrahje financiare për,

- Asociacionin e Psikiatërve të Kosovës me vlerë prej 2,245.00€;
- Shoqatën e Mikrobiologëve të Kosovës me vlerë prej 4,700.00€;

- Shoqatën e Nefrologëve të Kosovës me vlerë prej 5,000.00€;
- Shoqatën e Neonatologëve të Kosovës me vlerë prej 10,000.00€;
- Shoqatën e Obstetërve/Gjinekologëve të Kosovës dhe Spitali “Fati Im” me vlerë prej 10,000.00€;
- Shoqatën e ORL – Kirurgëve të kokës dhe qafës të Kosovës me vlerë prej 1,600.00€;
- Shoqatën e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë me vlerë prej 4,800.00€;
- Shoqatën Kosovare të Mjekimit Intensiv dhe Kujdesit Perioperativ me vlerë prej 10,000.00€;
- Shoqatën e Pediatërve të Kosovës me vlerë prej 4,950.00€;
- Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Ferizajit me vlerë prej 1,800.00€.
- Dhjetë punimet shkencore më të mira të publikuara përgjatë vitit 2022, me vlerë prej 10,000.00€.
- Trajnimet profesionale për mjekët e Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit me temë “trajnimi për Ultratingull Osteomuskular” dhe “Sistemi i menaxhimit të cilësisë dhe zhvillimin e aftësive udhëheqëse dhe menaxheriale të Spitaleve”. Vlera për organizimin e trajnimeve është 29,603.00€

11.3 Prokurimi

Gjatë periudhës kohore prill - qershor 2023 u zhvilluan katër procedura për vlera të vogla të prokurimit.

Në muajin prill u zhvillua një (1) procedurë për vlera të vogla të prokurimit për renovimin e zyrës së re të pranuar në shfrytëzim nga OMK. Procedura e prokurimit u zhvillua me sukses dhe brenda afatit u lidh kontrata me një operator ekonomik.

Në muajin maj u zhvillua një (1) procedurë për vlera të vogla të prokurimit për blerjen e printerit multifunksional i cili do të shërben për të gjithë OMK-në. Procedura e prokurimit për furnizim u zhvillua me sukses dhe brenda afatit u lidh kontrata me një operator ekonomik.

Në periudhën qershor u zhvilluan me sukses dy procedura të prokurimit me vlera të vogla për përzgjedhjen e OE që do të ofrojnë shërbime të edukimit të vazhdueshëm profesional për stafin e Odës lidhur me përdorimin e excel-it dhe kursit të gjuhës angleze. Procedurat e prokurimit u zhvilluan me sukses dhe brenda afatit u lidhën kontratat me dy operatorët ekonomik për këto dy trajnime. Trajnimet janë të

planifikuara që të mbahen nga mjetet e siguruar nga marrëveshja e përbashkët me Projektin KSV/017, Qeveria e Luxemburgut.

12 Aktivitete të tjera

12.1 Botimi i Revistës Mjeku

Gjatë periudhës Prill-Qershor u Publikua Revista Mjeku - Sëmundjet Reumatike.

Në muajin Qershor u bë publikimi i Revistës me temën bosht “Sëmundjet Reumatike”.

Ky numër përmban 13 artikuj, të përmbledhura në 47 faqe dhe në përmbajtje trajton këto tema: Imazhëria në diagnostikimin e spondilitetit ankilozant, skleroza sistemike, Osteoporozë, sëmundjet reumatizmale tek adoleshentët etj. Te aktualitete në OMK trajtohet tema e profilizimeve në Odën e Mjekëve të Kosovës dhe tek Këshillat Juridike këtë herë është trajtuar tema e anëtarësimit, rinaëtarësimit, kuota e anëtarësisë dhe rianëtarësimit.

Revista është e publikuar edhe online në faqen e Odës së Mjekëve të Kosovës në mënyrë që të arrijë audiencë më të gjerë. Linkun e gjeni të bashkangjitur më poshtë.

[Revista Mjeku](#)

12.2 Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim

Oda e Mjekëve të Kosovës dhe projekti i Luxembourg Development KSV/017, në vitin 2022 kanë nënshkruar marrëveshje për delegimin e fondeve dhe implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve të stafit mjekësor të Spitaleve të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit.

Marrëveshja ka të bëjë me zbatimin e aktiviteteve të programit për trajnimin dhe zhvillimin profesional të mjekëve të spitaleve përkatëse. Program i cili është hartuar mbi planin e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën 2022-2026 dhe përmes këtyre trajnimeve mjekët e këtyre spitaleve do të kenë mundësi të ngrisin shkathtësitë dhe njohuritë e tyre në apektin profesional.

Në këtë drejtim Oda e Mjekëve në bashkpunim me Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit, kanë identifikuar nevojat për trajnime dhe si rezultat ka filluar procesi i rekrutimit të trajnerave të kualifikuar apo insitucioneve për të implementuar trajnimet e nevojshme.

Në muajin maj 2023, u organizua trajnimi nga lëmia e ortopedisë me temë trajnimi për Ultratingull Osteomuskular. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin mjekët të Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit.

Trajnimi u organizua nën drejtimin e Prof.dr. Bujar Shabani dhe Dr.Dafina Bytyqi Shabani. Përmes këtij trajnimi mjekët kanë përfituar aftësi për të ofruar shërbime të specializuara për pacientët dhe t'u mundësojë atyre që të njihen dhe të jenë kompetent në kuptimin, funksionimin dhe aplikimin e pajisjeve ekzistuese në punën e tyre të përditshme në diagnostifikimin klinik brenda departamenteve të tyre spitalore.

Projekti i Luxembourg Development KSV/017, në vitin 2022 fillimisht ka alokuar vlerën prej 120,000.00€ kurse në fund të vitit 2022 pas suksesit të treguar nga OMK për realizimin e trajnimeve, marrëveshjes bazë i është shtuar amandamenti 1, ku janë alokuar mjete shtesë për implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve të odës, si dhe mbështetjen për organizimin të trajnimeve profesionale-profilizimeve për një numër të përzgjedhur të mjekëve nga spitalet e përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit.

Si pjesë e amandamentit 1 të marrëveshjes (DAFI KSV/017•21 2749), përfaqësues nga Oda e Mjekëve të Kosovës në bashkëpunim me përfaqësues nga projekti i Qeverisë së Luksemburgut për shëndetësi KSV/017 dhe përfaqësues nga Spitali i Përgjithshëm i Gjilani dhe Prizrenit kanë vizituar Spitalin e Përgjithshëm Izola, Murska Sobota dhe Celje në Slloveni. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë për të diskutuar dhe finalizuar marrëveshjen për realizimin e trajnimeve profesionale për mjekët e Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit. Mjekët e Spitalit të Gjilanit dhe Prizrenit do të përfitojnë nga marrëveshja e trajnimeve profesionale që do zgjasin sipas kërkesave dhe nevojave, e që kryesisht do të jenë të fokusuar nga lëmia e Kardiologjisë intervente, Laparaskopisë, Mjekësisë Emergjente dhe Menaxhimit shëndetësor dhe cilësisë të Spitaleve.

Me datë 17 mars 2023, OMK ka nënshkruar marrëveshje partneriteti me Spitalin e Përgjithshëm Izola, Murska Sobota dhe Celje nga Sllovenia për ngritjen e kapaciteteve klinike të stafit mjekësor të Spitaleve të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit. Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të shërbejë si platformë për shkëmbimin e përvojave më të mira dhe gjithashtu do t'u mundësojë mjekëve të Spitaleve të Prizrenit të Gjilanit dhe Spitaleve Sllovene të përfitojnë dhe zhvillohen profesionalisht përmes shkëmbimit të përvojave.

Si pjesë e marrëveshjes me spitalet Sllovene në muajin qershor, Oda e Mjekëve të Kosovës ka filluar me implementimin e Programit për Mbështetjen e Shëndetësisë në Kosovë, me fokus në Sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe zhvillimin e aftësive udhëheqëse dhe menaxheriale të Spitaleve, trajnim ky për menaxhmentin dhe mjekët e Spitalit të Përgjithshëm të Prizrenit dhe Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit.

Trajnimi u organizua nën drejtimin e Z. Radivoj Nardin, Drejtor gjeneral i Spitalit të Përgjithshëm Izola, Znj. Nevenka Romih, drejtoreshë e planifikimit, zhvillimit dhe

financave e Spitalit të Përgjithshëm Izola dhe Z. Marko Markežič, drejtor i departamentit të teknologjisë informative dhe mirëmbajtjes teknike i Spitalit të Përgjithshëm Izola, të cilët kanë ligjëruar specifikisht për transformimin dixhital të spitalit, plani analitik dhe zhvillimi në spital, mjetet e menaxhimit në spital, planifikimi dhe fokusimi i menaxhimit për Spitalin, etj.

Ndërsa deri në fund të vitit janë planifikuar të organizohen 9 trajnime bashkëpunuese dhe vizita mes mjekëve të spitaleve Sllovene dhe mjekëve të Spitave të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit. Për secilën trajnim mjekët nga Kosova do të kenë mundësinë të vizitojnë spitalet në slloveni dhe të përfitojnë nga përvoja e organizimit të punës në këto spitale, ku gjithashtu ekipi i mjekëve nga Sllovenia do të kenë mundësinë të vizitojnë spitalet e Gjilanit dhe Prizrenit.

12.3 Ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së

Në kuadër të marrëveshje për delegimin e fondeve dhe implementimin e aktiviteteve, është e përfshirë edhe ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së. Në fazën e parë janë organizuar trajnime të ndryshme gjithëpërfshirëse, si dhe ato specifike si kursi për Procedurat e përgjithshme administrative. Kurse sipas planifikimit në fazën tjetër përgjat këtij viti do të organizohen edhe trajnime profesionale. Këto trajnime do të kenë ndikim të rëndësishëm pozitiv në zhvillimin dhe organizimin administrativ dhe profesional të OMK-së dhe në ofrim të cilësisë së shërbimit.

12.4 Marrëdhëniet ndërkombëtare

Gjatë muajve maj dhe qershor përfaqësues të Odës së Mjekëve të Kosovës morrën pjesë në Asamblenë e Odës së Mjekëve të Gjermanisë si dhe në takimin e 37 vjetorit të Forumit Evropian të Shoqatave Mjekësore

Asambleja e Odës së Mjekëve të Gjermanisë në muajin maj mbajti punimet e rregullta vjetore, e cila këtë vit punimet u zhvilluan në Essen. Tema diskutimi gjatë mbledhjes ishin çështje të rëndësishme politikave dhe reformave që prekin sektorin e shëndetësisë si dhe zhvillimet e fundit në këtë sektor, ku ndër pikat kryesore të diskutimit ishin “Edukimi shëndetësor: Nga dija në veprim” dhe “Liria dhe përgjegjësia në profesionin e mjekut”.

Ndërsa nikoqir i takimit të 37 vjetorit të Forumit Evropian të Shoqatave Mjekësore, ishte Oda Polake e Mjekëve dhe Stomatologëve e që u organizua në Varshavë. Temat

kryesore që u trajtuan në këtë takim ishin Mjekësia në kohën e konflikteve, Migrimi i fuqisë punëtore të kujdesit shëndetësorë, kujdesi shëndetësor për refugjatët dhe Rehabilitimi.

12.5 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, Gjykatat Themelore ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën prill-qershor	Vendimet sipas urdhëresave/kërkesave të pranuar për periudhën prill-qershor	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën prill-qershor	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Kryetari i Odës	3	2	6	2	0

13 Plani i veprimit për 2023

Projektet/Planet 2023

- Fillimi i zbatimit të Projektit për ndërtimin e objektit për të gjitha OPSH-të, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë” dhe OPSH-të.
- Fillimi i zbatimit të sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit është 2.5 vite.
- Organizimi i Kongresit të V multidisiplinar
- Organizimi i ceremonisë së 10 vjetorit të formimit të OMK-së
- Fillimi i zbatimit të projekteve për profilizim dhe shkollim specialistik jashtë vendit
- Vazhdimi i zbatimit të Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim KSV/017 - 21 2749, faza e dytë për bashkëfinancimin e projektit të profilizimit të mjekëve
- Hulumtim për vlerësimin e ngarkesës së sëmundjes kronike dhe sindromit burnout (shpenzimi profesional i mjekëve)